

GUSHT 2015



BULLETINI MUJOR

Tel/+355 4 235 726

shgpaz.albania@yahoo.com

info.shgpaz@yahoo.com

www.shgpaz.al



Ne Bashkine e San Vitos, Sardenje, 4 gusht 2015



San Vito: qyteze ne afërsi te kryeqytetit sard, një larg ore nga Kaliari; një komune e vogël, me njez te mire, te bute, punëtorë dhe mjaft mikpritës; te bie ne sy menjëherë se ngjarjet e përditshme te përcillen me dialekt sard (pak spanjisht e pak italisht) jo lehte për t'u kuptuar; madje një RAI TV SARDENJA; ne lokale dëgjohet muzike latine, por atmosfere alla italiane; mjaft gjallëri humane dhe një mori aktivitetimesh; e gjithë Sardenja ishte turistike, ke çfarë kërkon, çfarë sheh, çfarë mëson e shijon .Edhe pse dite pushimesh dhe vere shume e nxehte, shpesh mbi 40 grade; ne këtë qyteze, për një jave qe qëndruam, eventet ishin pafund:

procesioni i Santa Barbares, mini-panair artizanal, shfaqje me këngëtare live, parade mode, gare çiklistike familjare me femije nga tre vjeç e sipër, ftese përshpirtje falënderimi, piktore te njohur, por te thjeshte ne mjedise modeste; politika është fundit për te cilën flasin, madje flasin mire për Musolinin, i cili sipas tyre i kishte zhvilluar e

ndihmuar, dhe vinin ne loje dhe shigjetonin Rencon,

kryeministrin riosh; sigurisht ne nje buletin nuk mendoj se duhet te zgjatem, por lidhja e këtij

pushimi personal, me informacionet e tjera turistike ose jo, ishte prezentë per mua cdo moment; si mund te bëjmë diçka me mire Ne, ne Shqiperi, per biznesin, kulturën, historinë, politiken

etj.

bashkie

dispozicion te popullit, te gatshëm edhe per te huajt, sic ishim ne te dyja me Albanen; edhe pse kryetarja nuk

Konkretisht interesante ishte se per here te pare kishin kryetar një grua(parti e majte), nja bashki e mireqeverisur, te gjithë nëpunësit ne ishte, zëvendësja nje zonje e edukuar, na paraqiti gjithë mjediset

funkionale te bashkisë, sallat dhe materialet ne ndihme te komunitetit dhe e gatshme te bashkëpunonim ne fushën e biznesit femeror dhe ne ate te edukimit; shume afër bashkisë ishte nje muze mjaft informues, ne pamje vogel, por me te gjitha treguesit kohore;; kaluam



i

2 ore pa u mërzhitur madje mjaft interesant me dokumentarin e Kruges se argjendit, ku historia e 4 minierave te argjendit qe ne vitin 1765, ishin punësuar mijëra burra edhe gra, ishin punësuar e zhvilluar per nje shekull, mijëra sardë; ajo qe ne na mungon, ishin info point me vajza e djem te ri , me gjuhe te huaja qe te drejtonin mrekullisht ne qytezat e tjera per te pare plazhet e detit, te virgjëra, te pastra kristal, te rregullta dhe te qeta, ku edhe pse me nje çmim hyrës te kripur, kënaqësia ishte plote dhe shijojte plotësisht ujin e mrekullueshëm te detit, pamjet magjike dhe edukatën e njerëzve përreth.bregdetet tona... mund te jene shume te bukura, por na mungojnë nje shumice gjerash thelbesore, per ti bere te cilësie se dyte, me e pakta.

Universiteti i Kaliarit, Sardenje



Kaliari, kryeqyteti Sadenjes dhe per vitin 2014, ishte kryeqyteti i i kulturës italiane, nuk mund te shihet vetëm si turist, me nje guide te zakonshme me autobus te specializuar per te turistet, ku ndalesat jane te planifikuar dhe guida ne te ndryshme qe te shpjegon ku ndoshesh dhe cfare përfaqëson ndërtesa, pamja, skultura , muzeu etj. Por me tërheqin gjithmonë bibliotekat dhe artizanti vendas, ku qe te dyja përfaqësojnë zhvillimin e nje vendi. Salla te cilën fotografova, quhesh; e peseqinedesht, sepse ky Universitet, me fanatizëm ruan bibliotekën shume te pasur dhe antike, deri edhe pergamene te ruajatur mjaft mire, nje kuratore e materialeve te arshivuara pati mirësinë te na shpjegonte sallën historike antike dhe me mirënjohje ne librin e përshtypjeve falënderova ate dhe grupin a stafin e kësaj biblioteke. qe ju shihni. PUSHIMET ME TE NXEHTA Sardenja te huton: e varfer, e bukur, here e padijshme, por perditësi interesante; sado te lexosh, kur e sheh me syte e tua, ben vleresimin me vendin tend.



Sarande, edicioni i 4-t i Panairit Kombëtar te Suvenireve Turistike "SARANDA 2015" 13-15 Gusht 2015

SHGPAZ, si ne çdo edicion, përgatitet mire për te qene e pranishme, dhe grupi i artizaneve tashme njeh çdo skute te këtij qyteti bregdetar jonian. Drejtuesja e grupit zonja Meliha Zyberi dhe koordinatorja e shoqatës zj. Klodiana Dragoshi, u përkujdesen jo vetëm për sistemimin sa me te shpejte dhe komode te 8 artizaneve tona, por me nje axhende te mirëpërgatitur, i drejtoi gratë per te përballuar shitjet, për te komunikuar me klientët e huaj dhe vendas, për tu takuar me përfaqësuesit lokale si dhe për te bashkëpunuar me te gjitha zejtares nga qytete te ndryshme te Shqipërisë si dhe nga trevat shqiptare.

Nje mbeshtetje per kete panair ishte dhe kryetarja e bashkise, znj.Florina Koka.Me deshiren e mire per te promovuar turizmin dhe per te rikthyer vlerat e punimeve artizanale, znj.Koka theksoi qe promovime te tilla do te marrin mbeshtetjen maksimale nga ana e bashkise duke ofruar risi dhe bashkepunime efektive. Nga organizatorete u shperndane edhe certifikata per artizanet pjesemarrese. Interesi per artin e tyre ishte shume i madh edhe nga turistet sezonal te qytetit, here per te shuar kureshtjen dhe here per te marre nje suvenir te vogel me vete. Kosova u perfaqesua denjesisht nga artizane nga Prishtina dhe Prizreni. Punimet e tyre ishin vertete mjaft cilisore dhe te bukura.

Pergezime per organizatorete dhe falenderim per mundesine qe na ofruat per te qene pjese e ketij eventi. Pune te mbare dhe suksese te metejshme per te dyja palet! Mirëutakofshim vitin tjetër !





Ulqin, Mali i Zi

Ulqin, Mali i Zi

21- 23 gusht 2015, u zhvillua panairi rajonal i punimeve me dore, i zejtarisë dhe produkteve me te mira vendase dhe rajonale. Ne vijim te bashkëpunimit me këtë kompani panairesh, mjaft aktive, pjesëmarrja jone ka qene e përherëshme, me mjaft përfitime dhe mundësi bashkëpunimi dy- a me shume- palesh. Ne datat sa sipër morën pjese 2 gra artizane, me punimet e tyre cilësore te qilimave te Zogajt, Shkoder punuar në atelietë e Ganimet Artunda dhe Nebije Çotaj.

Ftesa vijon te jete e hapur për SHGPAZ, falënderojmë organizatoret.



**NVO Globus art
Ulcinj/ Ulqin**

**OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA ULQINIT**


POZIVNICA

Postovanje,

NVO Globus art iz Ulcinja, od 21.08. do 23.08.2015 organizuje III međunarodni sajam umjetnina i zanatlija u Ulcinj, na maloj plaži gdje će biti oko 100 izlagača iz zemlje i regiona balkana.

Takodje vas obavijestimo da sajam pocinje svaki dan od 16:00 do 23:30 h. Pozivamo Vas da učestvujete kao izlagač sa svojim radovima. Svaki učesnik sajma imaće obezbijedjen svoj štand.

Dobro došli!



FTESE


i/e nderuar,

OJQ "Globus Art nga Ulqini, prej datës 21.08. deri më 23.08.2015 organizon panairin e III ndërkombëtarë me Artistë dhe Artizanë, në plazhin e vogël në Ulqin ku do të marrin pjesë afër 100 pjesmarrës nga vendi dhe rajoni i ballkanit. Gjithashtu ju njoftojmë që panairi do të filloj çdo ditë prej orës 16:00 deri në orën 23:30 h.


Ju ftojme që të merrni pjesë me punimet tuaja në këtë panair.

Çdo pjesëmarrës në panair do të ketë të siguruar vendin e vet për ekspozim.

Ju mirëpresim!



GLOBUS ART
Ramiz Hajdari




Kontakt tel: +382 69 818 830
e-mail: globusart_ul@hotmail.com

SEECCEL- qendra e Europes juglindore per te mesuarit sipermarrjes, me seli ne Zagreb, po drejton qe nga viti 2012 projektin ballkanik „Sipermarrja femerore - makineri pune krijuese per EJM“. Krahas te gjitha trajnimeve dhe kualifikimeve mjaft cilesore, kjo qender kete vit ka pasur ne fokus tri indikator te rendesishem per te percaktuar “ Praktikant me te mira te grave ne biznes”. Ne baze te kesaj, ne takimin ne Zagreb, prill 2015, u realizua nje dokumentar me ndermarreset me te spikatura, 4 perfaqesuese per secilin vend, dhe Ne, u prezantuan me 4 biznese te mira, te qendrueshme, me tregues progresiv kohore dhe me perspektive te qarte. 1. *Instituti privat Flutra&Bijte*, drejtuar nga *znj. Flutura Xhabija*, 2. *Shkolla jopublike Numani*, drejtuar nga *znj. Suzana Numani*, 3. *Fabrika Fasoneri italiane*, drejtuar nga *znj. Karolina Vaso*, dhe ekspertiza private e *patentave dhe markave* drejtuar nga *znj. Albana Laknori*.

Kjo pervoje u mendua qe cdo vend pjesemarrjes ne kete projekt (9 vende te Ballkanit) ta perhape kete aset praktik e shkencor ne favor te zhvillimit te sipermarrjes femerore.

SHGPAZ, pasi e vleresoi shume kete indikator kyç per suksesin e nje biznesi, vendosi te beje konferenca apo seminare po ti quajme, ne tri qytete, jo ne nje sic na rekomandoi donatori. Nisma jone, edhe pse per nje kohe te shkurter, u realizua me shume cilesi dhe efektivitet ne Pogradec-21 gusht, Fier -27 gusht dhe Vlore-28 gusht; feedback-u i planifikuar i kaloi kufijte dhe pjesemarrja ishte mjaft e mire (edhe pse ishte kohe e ngarkuar me pikun e turizmit), pushteti lokal dhe qendror ishte i pranishem si dhe media pasqyroj aktivitetet realisht dhe shikuesit shprehen kenaqesine e tyre edhe nepermjet rrjeteve sociale (1355 like per Fierin, 630 per Pogradecin dhe 380 per Vloren); pertej objektivit, u krye nje freskim i anetereve me pjesemarrje moshore me te re si dhe me nisma konkrete; ne muajin shtator do te nxjerrim te gjitha rezultatet ne keto tri takime, ne forme tabelash dhe analizash respektive si dhe nje hartim te plan veprimit deri ne dhjetor 2015.



Në Pogradec, me 22.08.2015, ne sallën e mbledhjeve ne hotel Enkelana , nen patronazhin e e krytares se keshillit bashkiak te Pogradecit znj.Natalja Velo ,per here te pare nje grua , u mbajt konferenca lokale në kuadër të Projektit Rajonal "Gratë sipërmarrese-makineri pune krijuese për Evropën Juglindore", organizuar nga SHGPAZ drejtuese kryesore e grave biznese nga Shqiperia dhe SEECEL - qendra e Evropës juglindore per te mesuarit sipërmarres, me seli në Zagreb, Kroaci, me teme "ALBANIA BEST PRACTICES".

Eventi kishte per qellim te promovojte grate ne biznes; te perhape praktikat me te mira te sipërmarreseve gra, te informojte format me kohore per te pasur sukses te perhershëm ne biznesin e tyre, te gjenden rruget me te qarta per zgjidhjen e pengesave dhe te mbështetin njera tjetren, te bashkëpunojne dhe te kene nje partneritet te qendrueshem me aktoret me aktiv qofte privat a shtetore, qofte politike a ekonomik. për të përmirësuar sa me mire e sa me shpejt mjedisin për ndërmarrësinë femerore.



Konferenca e 2-te u organizua ne Fier,

me mbeshtetjen e deges se SHGPAZ-se, ne kete qytet. Hapja e takimit u be nga presidentja e shoqates kombetare te biznesit zj.Futura Xhabija, e ndjekur nga zonja Suzana Numani.

Znj. Suzana Numani, dekoruar dhe fituese e kombetare dhe rajo TICES“, te ketij perzgjedhurat nga zgjedhur keshill tare e



grua ne biznes, disa here disa cmimeve lokale e nale. Ne "BEST PRAC projekti, ajo ishte nder 4 te Shqiperia; ajo sapo eshte bashkise se Fierit.



Drejtorja ekzekutive e SHGPAZ, znj.Albana Laknori, ne prezantimin e projektit dhe te formatit rajonal BEST PRACTICES, insistoi ne perdorimin e praktikave me te mira, ne te gjitha deget e shoqates, konkretisht edhe ne Fier, ku numri i grave ne biznes eshte i madh dhe me ndikim te njohur social-ekonomik lokal.



Konferenca e 3-te u zhvillua ne qytetin e Vlores,

diten e premte, më 28 gusht 2015



Konferenca u organizua nga SHGPAZ, me mbeshtetjen e deges se saj ne kete qytet. Prezantimin e qellimit te takimit e paraqiti zonja Albana Laknori, duke shpjeguar me slajte dhe filmime , konceptin e nje praktike te mire, indikatoret kryesore per te qene shembull dhe mundesia e promovimit te modeleve shqiptare ne fushen e siper marrje roze, numri i te cilave eshte mjaft i larte. Ne vijim zonja EVGJENI MUSKAJ, kryetarja per degen e Vlores, grua me disa biznese, gjithmone ne mbeshtetje siper marrjes femerore, diskutoi per disa problem dhe sfida te biznesit edhe te grave te Vlores. Ne sallën e konferencave te universitetit te saj privat „REALD“, ajo prezantoi fuqine social-ekonomike te grave sipermarrese vlonjate dhe arritjet ne kete fushe; mjaft nga ato jane biznese per tu marre shembull dhe per te qene nje model real dhe kohor zhvillimi vendor dhe me tej; edhe ne fushen e shifrave kontributi i biznesit femeror vlonjat eshte i permasave te medha, madje shpesh edhe konkurrues me burrat.





VEPRIMTARITE KRYESORE MUJORE

data	tema	partneri	Shteti/ qyteti	Nr. pjesemarreseve
3	Binjakezim me komitetin e sipermartjes femerore	Dhoma treg. Kaliari	Itali	2
7	Pushteti lokal per SF	Bashkia e San Vitos	Itali	2
11	Takim pune Drejtorine rajonale te aftesimit profesional nr.2	SHGPAZ	Tirane	1
13-15	Panair IV i suvenireve artistike	AJMMI	Sarande	8
19	Trajnim mentoring ne Maqedoni-Shqiperi-Kosove	Ambasada Hollandeze	Tirane	2
22	SEECEL	SHGPAZ	Pogradec	20
21-23	Panair rajonal	NVO Globus art	Ulqin	2
27	SEECEL	SHGPAZ	Fier	20
28	SEECEL	SHGPAZ	Vlore	20
9 aktivite tematike		6 partnere	3 shtete, 10 qytete	77 veta

ky buletin u pergatit nga Flutura Xhabija,
ndihmoi Klodiana Dragoshi